



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**Anr. 351/2014**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Ferit Osmani, dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Naim Mustafës anëtarë i PDK-së respektivisht përfaqësues dhe djali i Emine Mustafës (person me probleme shëndetësore) nga fshati Kmetoc komuna e Gjilanit, paraqitur kundër KKZ-së në Gjilan (Ekipi Mobil nr 2 të zgjedhjeve/ Hendikos- Gjilan) për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 12.06.2014, mori këtë:

**VENDIM**

**Hidhet e palejuar** ankesa e subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR)

**Arsyetim**

PZAP-i, me datën 11.06.2014 ka pranuar një ankesë nga Naim Mustafa (anëtar i PDK-së) në emër të nënës së tij Emine Mustafës (person i moshuar dhe me probleme shëndetësore) nga fshati Kmetoc, komuna Gjilanit në të cilën theksohet se me datën 08.06.2014 ekipi mobil nr 2 edhe pse kanë qenë në fshatin Kmetoc të Gjilanit nënës së tij nuk i kanë mundur të votojë, edhe pse Emine Mustafa ka votuar në të gjitha zgjedhjet, me çka mund të vërtetohet nga listat votuese të zgjedhjeve të kaluara, dhe ato të fundit komunale. Edhe përkundër insistimit të tij në KKZ që të angazhojë këtë ekip mobil që të shkojë përsëri në fshat, përgjigja që kishte marrë ishte që ekipi i ka kryer punët më herët edhe materialin zgjedhor e ka dorëzuar në KKZ. Andaj parashtruesi i ankesës kërkon nga PZAP-i ndërmarrjen e masave ligjore ndaj këtij ekipi. Këto veprime sipas parashtruesit të ankesës janë në kundërshtim me dispozitat ligjore të LZP-së dhe me Rregullat Zgjedhore.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi lejueshmërinë e ankesës gjeti se :

**ankesa është e palejuar**

PZAP-i, konstaton se pretendimet ankimore ndaj ekipit mobil të OJQ-së së HANDIKOS se nuk i kanë ofruar shërbimin për të votuar personin në fjalë janë të palejuara nga se nuk është në juridiksionin e PZAP-it që të vendos për ofrimin e shërbimeve ndaj ekipeve mobile. Për më tepër kompetencat e PZAP-it specifikohen në dispozitën e nenit 122 par.1 pikat a, b, c, d, e dhe f, meqenëse në asnjërin nga pikat e lartëpërmenduar të dispozitës nuk kanë rënë pretendimet e parashtruar në

ankesë, vendosi si në dispozitivë të këtij vendimi duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në Prishtinë**

Anr. 351/2014 më datën 12.06.2014



***Udhëzim Juridik:***

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*